

RAPORT VJETOR



Letër nga Menaxhmenti

Të dashur miq, partnerë dhe mbështetës të GERMIN,

Viti 2025 ishte një vit i angazhimit të thelluar, i zgjerimit të bashkëpunimeve dhe i dëshmisë së qartë se diaspora shqiptare mbetet një nga burimet më të rëndësishme të dijes, kapitalit shoqëror, përvojës profesionale dhe përgjegjësisë qytetare për zhvillimin e vendit dhe të komuniteteve tona kudo në botë.

Në një kohë kur lidhjet mes njerëzve, institucioneve dhe vendeve po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, GERMIN vazhdoi të shërbejë si urë mes diasporës dhe vendlindjes. Përmes programeve tona, gjatë vitit 2025 ne punuam për të forcuar pjesëmarrjen demokratike të qytetarëve jashtë vendit, për të sjellë ekspertizën e profesionistëve të diasporës më afër institucioneve dhe komuniteteve, për të mbështetur gratë në politikë, për të lidhur akademikët dhe sipërmarrësit me universitetet dhe ekosistemet e inovacionit, si dhe për të krijuar hapësira ku të rinjtë nga diaspora mund të njohin më thellë historinë, kulturën dhe identitetin e tyre.

Ky raport përmbledh vetëm një pjesë të kësaj pune. Pas çdo numri qëndrojnë njerëz, takime, ide, partneritete dhe histori personale. Diaspora Flet në Këln dëshmoi fuqinë e bashkimit të komuniteteve rreth dialogut, kulturës, teknologjisë dhe bashkëpunimit. OriginAL vazhdoi të krijojë lidhje të gjalla mes të rinjve dhe prejardhjes së tyre. Diaspora4Innovation tregoi se akademia dhe inovacioni mund të përfitojnë drejtpërdrejt nga ekspertiza shqiptare jashtë vendit. Ndërsa nismat filantropike dhe ato të investimeve riafirmuan se angazhimi i diasporës nuk është vetëm mbështetje financiare, por edhe besim, përgjegjësi dhe vizion afatgjatë.

Një pjesë e rëndësishme e punës sonë gjatë këtij viti lidhet edhe me përpjekjen për ta bërë pjesëmarrjen e diasporës më të strukturuar, më të qëndrueshme dhe më ndikuese. Për GERMIN, diaspora nuk është vetëm komunitet që ruan lidhje emocionale me vendlindjen. Ajo është partnere në demokraci, në arsim, në ekonomi, në kulturë dhe në zhvillim institucional. Prandaj, puna jonë i shërben strukturimit të lidhjeve që përkthejnë vullnetin dhe dashurinë për atdheun në ndikim real.

Jemi mirënjohës për të gjithë ata që e bënë të mundur këtë vit: ekipin tonë, bordin, partnerët institucionalë, donatorët, organizatat komunitare, profesionistët, vullnetarët dhe çdo individ që beson në misionin tonë. Besimi është burimi i përgjegjësisë dhe angazhimit tonë.

Në vitin 2026, do të vazhdojmë të ndërtojmë mbi këto rezultate, me më shumë fokus në partneritete strategjike, fuqizim të të rinjve, mbështetje të grave, pjesëmarrje demokratike dhe zhvillim ekonomik. Sfidat tona mbetet të qartë: ta kthejmë potencialin e madh të diasporës shqiptare në mundësi konkrete për njerëzit, institucionet dhe shoqëritë tona. Faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi.

Me respekt,

Sihana Bejtullahu dhe Lirim Krasniqi

Bashkë-Drejtuues Ekzekutiv, GERMIN



Avokimi dhe Diplomacia

Diaspora Flet 2025, Këln

Diaspora Flet 2025 solli energji të re në Këln, duke bashkuar komunitete shqiptare dhe ndërkombëtare rreth ideve, përvojave dhe bashkëpunimeve që kalojnë kufijtë. Gjatë diskutimeve u theksua roli i artit, kulturës dhe medias në forcimin e identitetit dhe integritetit në shoqëritë pritëse. Pjesëmarrësit ndanë përvoja që treguan se lidhja me prejardhjen ndihmon në ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe besimit.

Një fokus i veçantë iu kushtua thellimit të bashkëpunimit mes nismave të diasporës dhe institucioneve, duke treguar se praktikrat që funksionojnë fitojnë vlerë kur ndahen dhe zhvillohen përmes partneriteteve të reja. Teknologjia dhe inovacioni u prezantuan si faktorë lidhës mes ekosistemeve ndërkombëtare, ndërsa rëndësia e arsimit dhe gjuhës amtare u theksua si bazë për vetëbesim dhe pjesëmarrje aktive të brezave të rinj.

Diaspora Flet 2025 krijoi një klimë bashkëpunimi që vazhdon përtej konferencës.

Vota e Diasporës

Në kuadër të programit “Avokimi dhe Diplomacia”, GERMIN kontribuoi në mbikëqyrjen e votës së diasporës në dy palë zgjedhje nacionale dhe një palë zgjedhje lokale, duke mbështetur transparencën dhe përfshirjen demokratike të qytetarëve jashtë vendit. GERMIN ka publikuar edhe analizën gjithëpërfshirëse mbi Votën e Diasporës.

1

Konferencë
ndërkombëtare
Diaspora Flet në Këln

157

Pjesëmarrës

3

Palë zgjedhje të
monitoruara
për votën e
diasporës

Profesionistët e Diasporës

Angazhimi i profesionistëve të diasporës mbeti një nga shtyllat kryesore të punës së GERMIN gjatë vitit 2025, duke lidhur ekspertizën ndërkombëtare me nevojat konkrete të institucioneve, universiteteve dhe komuniteteve në Kosovë dhe Shqipëri. Përmes bashkëpunimeve të strukturuar, programet e këtij drejtimi synuan të kthejnë dijen, përvojën dhe rrjetet e diasporës në ndikim të qëndrueshëm në arsim, politikë dhe zhvillim profesional.

Platforma “Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës - EDP”

Programi EDP sjell ekspertët nga diaspora në Kosovë për të kontribuar në zhvillimin e vendit me njohuritë dhe përvojat e tyre nga vendet e zhvilluara. Bazuar në databazën e GERMIN që përfshin mbi **30,000 profesionistë** në mbarë botën, programi realizon angazhime nga 3 javë deri në 6 muaj në institucione dhe organizata sipas nevojave të tyre.

Projekti “Diaspora për Gratë në Politikë”

Në kuadër të këtij programi u përmbyll projekti Diaspora për Gratë në Politikë, i cili përfshiu **54 gra nga 7 komuna të Kosovës**, anëtare të kuvendeve komunale ose kandidatë për asamble lokale. Projekti u mbështet nga **7 mentore nga diaspora dhe 7 eksperte, përmes 3 sesioneve të trajnimit dhe 7 iniciativave komunitare** që adresuan nevoja konkrete lokale. Përmes mentorimit, trajnimeve dhe angazhimit praktik, projekti forcoi rolin e grave në vendimmarrjen lokale, ndërsa konferenca përmbyllëse ofroi rekomandime konkrete për politika më gjithëpërfshirëse në nivel lokal dhe qendror.



1000+

profesionistë nga diaspora
të regjistruar në EDP

54

gra nga 7 komuna të Kosovës
përfutuese të projektit

14

mentore dhe eksperte nga diaspora

7

iniciativa komunitare

3


Sesione trajnimesh

Diaspora4Innovation

Në qershor 2025, GERMIN, në bashkëpunim me GIZ Albania dhe **8 universitete shqiptare**, nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit për lidhjen e diasporës akademike me arsimin e lartë dhe sipërmarrjen. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, u angazhuan **10 akademikë të diasporës** dhe u nënshkruan **8 memorandume bashkëpunimi** me universitete partnere.

U krijuan **12 bashkëpunime konkrete** mes studiuesve të diasporës dhe atyre rezidentë, duke përfshirë mbi **500 studentë** në fusha si energjia e ripërtëritshme, IoT dhe sipërmarrja, ndërsa 395 prej tyre përfunduan kurset e bashkëdizajnuara.. Akademikët bashkëdizajnuan 10 kurse, ndërsa 9 kurse u përfunduan me gjithsej 395 studentë përfitues.

Programi përfshiu gjithashtu **një vizitë studimore grupore në Itali dhe dy vizita studimore individuale nga akademikë vendas**, duke forcuar shkëmbimin akademik dhe profesional.



Në fushën e inovacionit dhe sipërmarrjes, **13 mentorë nga diaspora mentoruan 56 startupe në Shqipëri**. Bashkëpunimi akademik prodhoi **1 artikull konference të publikuar në Springer Proceedings dhe 1 prezantim kërkimor në READ Conference në Tiranë**. Si rezultat i drejtpërdrejtë i këtij angazhimi, u realizua **1 aplikim i suksesshëm për Horizon Europe** dhe u dorëzua 1 aplikim tjetër për grante të Bashkimit Evropian.

Këto rezultate tregojnë ndikimin konkret të diasporës akademike në forcimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe inovacionit në Shqipëri dhe rajon.



395

studentë

56

startupe të mentoruara

13

Mentorë startupesh

12

Bashkëpunime konkrete

10

akademikë nga diaspora

8

universitete shqiptare

1

artikull shkencor në Springer Proceedings

1

prezantim kërkimor në READ Conference

Filantropia e Diasporës



Në fushën e filantropisë së diasporës, viti 2025 u shënua nga disa kampanja të suksesshme të realizuara në bashkëpunim me Global Albanians Foundation dhe partnerë komunitarë. Përmes iniciativave si **Empowering Albanian Tech Stars of Tomorrow, Korçarët Ndhimjnë Korçarët, Support Kosovo's Young Talents in the Neo Science Olympiad 2026 dhe Empower Young Albanian Creators**, diaspora kontribuoi drejtpërdrejt në mbështetjen e të rinjve në shkencë, teknologji, kreativitet dhe industri digjitale. Këto kampanja mbështetën nxënës dhe të rinj të talentuar që përfaqësojnë Kosovën dhe Shqipërinë në gara ndërkombëtare, si dhe mbi 300 krijues të rinj që ndërtuan hapat e parë drejt karrierës në fushat kreative dhe teknologjike. Përmes këtyre nismave, filantropia e diasporës u shndërrua në investim të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

Ngjarja “Rrënjët që na Bashkojnë” në Cyrih, mbledhi komunitetin shqiptar në Zvicër rreth identitetit, përkatësisë dhe angazhimit për të ardhmen. Mbrëmja krijoi një hapësirë reflektimi dhe bashkëndarjeje, ku programi OriginAL u prezantua përmes një dokumentari dhe rrëfimeve personale të pjesëmarrësve, duke treguar ndikimin e drejtpërdrejtë të përvojës në jetën e të rinjve nga diaspora.

Në Cyrih, diaspora dëshmoi se filantropia nuk është vetëm mbështetje financiare, por edhe lidhje emocionale, përgjegjësi dhe vizion i përbashkët. Personalitete të njohura ndanë përvoja mbi rolin e diasporës në ndërtimin e së ardhmes, ndërsa bashkëpunimi me sponsorë dhe partnerë krijoi baza të reja për iniciativa të ardhshme në Zvicër dhe më gjerë, duke e shndërruar këtë ngjarje në një pikë referimi për angazhimin komunitar.

Mbrëmje të ngjashme u realizuan edhe në Këln dhe Zagreb



Të rinjtë dhe edukimi



OriginAL 2025

Në vitin 2025, OriginAL përfshiu 107 të rinj nga 23 shtete, të organizuar në 3 kohorta, duke shënuar rritje prej 85 për qind krahasuar me vitin 2024 dhe duke e çuar numrin total të pjesëmarrësve në 257 që nga viti 2022. Programi u zhvillua në Kosovë, Shqipëri dhe për herë të parë në Maqedoni të Veriut, me vizita në 14 qytete dhe mbi 70 lokacione historike, natyrore dhe institucionale.

Pjesëmarrësit vlerësuan programin me një mesatare prej 88 nga 100, duke raportuar lidhje më të forta emocionale me origjinën dhe njohuri të zgjeruara për historinë dhe kulturën. Angazhimi qytetar u reflektua edhe përmes 368 orëve vullnetare të realizuara nga pjesëmarrësit dhe 105 orëve mbështetje nga 27 alumni në proceset e përzgjedhjes. Programi u shënuar edhe nga momente dhe vende kyçe si Vlora, Krusha e Madhe, Prekazi dhe takimi me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

107

të rinj pjesëmarrës në
OriginAL 2025

70

lokacione historike,
natyrore
dhe institucionale

23

shtete të përfaqësuara

14

qytete të vizituara,
Kosovë, Shqipëri dhe
Maqedoni e Veriut

3

shtete të vizituara,
Kosovë, Shqipëri dhe
Maqedoni e Veriut

3

kohorta
udhëtimesh

Investimet e Diasporës



Diaspora si urë biznesi

Gjatë vitit 2025, GERMIN kontribuoi në debatin publik mbi rolin e diasporës në zhvillimin ekonomik përmes analizave dhe opinioneve që adresuan tregtinë ndërkombëtare, investimet dhe imazhin e Kosovës.

Publikimet theksuan rëndësinë e rrjeteve profesionale, certifikimeve ndërkombëtare dhe bashkëpunimit mes bizneseve vendore dhe diasporës. U ofruan rekomandime konkrete për krijimin e platformave lidhëse, organizimin e takimeve B2B dhe përfshirjen më aktive të diasporës në promovimin e produkteve dhe shërbimeve.

GERMIN, së bashku me biznese inovative nga Kosova, mori pjesë edhe në Panairin e Bizneseve Shqiptare në Austri, duke hapur mundësi të reja bashkëpunimi dhe rrjetëzimi ekonomik.

Viti 2025 na mësoi rëndësinë e partneriteteve të ndershme, të dialogut të hapur dhe të punës së përbashkët. Çdo projekt, çdo takim dhe çdo histori suksesi na rikujtoi se ndryshimi nuk vjen nga ide të mëdha të izoluar, por nga bashkimi i njerëzve që besojnë në të njëjtin qëllim. Në vitin 2026, GERMIN do të vazhdojë të ndërtojë mbi këto rezultate, duke zgjeruar bashkëpunimet dhe duke krijuar hapësira të reja për angazhim.

Faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi.

Follow



Misioni ynë është të shërbejmë si një urë e fortë dhe dinamike që lidh shqiptarët kudo në botë, për të nxitur leadershipin dhe inovacionin, për të rritur angazhimin dhe sipërmarrjen, si dhe për të lehtësuar dhe ndërtuar lidhje strategjike.

WWW.GERMIN.ORG